




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipality of Kaçanik

01.Nr. 16-30568/15  
Kaçanik, 29. 09. 2015

Në bazë të nenit 12 të Ligjit Nr.03/L-040- Për Vetëqëverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28 e datës 4 qershor 2008), lidhur me nenin 19 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-233- Për Mbrojtjen e Natyrës (Gazeta Zyrtare Nr. 85 e datës 9 nëntor 2010), si dhe Rekomandimit të Agjensionit për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë Nr.3644/15, të datës 14.07.2015, i cili vepron në kuadër të MMPH, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 29 shtator, 2015, mori këtë:

### VENDIM

#### **Për mbrojtjen e vlerës së natyrës të trungu i shelgut ( Salix - alba), në Kaçanik si monument i natyrës**

1. Me këtë Vendim merren nën mbrojtje vlerat e natyrës Trungu i Shelgut ( salix – alba) në Kaçanik, si monument i i natyrës i karakterit botanik (në tekstin e mëtejme: Monumenti i Natyrës).

1.1. Monumenti i natyrës ndodhet në qendër të qytetit afër urës mbi lumin Nerodime (Ura e Konakut) në lartësinë mbidetare 480 m, koordinatat: **LAT:42.227749, LONG:21.257004**.

1.2. Trungu ka perimetër prej 6.60 m, lartësi prej 10 m dhe një vjetërsi prej rreth 350 vjet.

1.3. Trungu është pjesërisht i dëmtuar në disa degë dhe me kurorë jo shumë të zhvilluar.

2. Monumenti i natyrës spas IUCN-it kategorizohet si vlerë e natyrës e kategorisë së III-të, *Natural Monument/ Natural Landmark* –Monument i Natyrës

2.1. Për monumentin e natyrës përcaktohet regjimi mbrojtës i shkallës së III-të të mbrojtjes në të cilin përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat në monumentin e natyrës ndalohet:

2.1.1. Prerja e trungut, thyrja (krasitja) e degëve,

2.1.2. Ndezja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur,

2.2.3. Mbjellja e bimëve me qëllim të gjelbërimit të sipërfaqës mbrojtur,

2.3.4. Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur,

2.3.5. Ndryshimi i pamjes së kurorës,

2.3.6. Çdo lloj aktiviteti tjetër i cili mund të shkaktojë ndryshimin apo dëmtimin e monumentit të natyrës.

2.2. Në Monumentin e Natyrës lejohen:

2.2.1. Të gjitha masat mbrojtëse biologjike-teknike të monumentit të natyrës nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për mbrojtjen e natyrës dhe në bazë të projektit për sanimin e gjendjes së monumentit të natyrës si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes së monumentit të natyrës.

3. Në zonën buferike të monumentit të natyrës ndalohet:

3.1. Ndërrimi kulturës,

3.2. Ngjitja e objekteve të cilat kanë ndikim në pengimin e pamjes së monumentit të natyrës.

4. Për zbatimin e masave mbrojtëse të monumentit të natyrës kujdeset Komuna e Kaçanikut.

4.1. Komuna është e detyruar :

4.1.1. Monumentin e natyrës ta mbrojë dhe ta mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara mbrojtëse,

4.1.2. Në rast të paraqitjes së ndryshimeve të cilat monumentin e natyrës mund ta shkatërrojnë ose ti dëmtojnë vetitë e rëndësishme të tyre , menjëherë duhet ta lajmërojë Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës,

4.1.3. Të bëjë shënimin e kufijve të monumentit të natyrës në pajtim me Rregulloren për shënimin e Zonave të Mbrojtura.

5. Planet hapësinore dhe urbanistike, projektet, baza ekonomikeo-pyjore, hiroekonomike duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e monumentit të natyrës.

6. Ky Vendim pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokolit të autoritetit mbikqyrës-MAPL-së, si dhe pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

7. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtoria e Emergjencës dhe Shërbimeve Publike.

**Me këtë Vendim njoftohen:**

1. Kryetari i Komunës,

2. Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit,

3. Drejtoria e Emergjencës dhe Shërbimeve Publike,

4. Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, dhe

5. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit  
Xhejal Gashi